



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Arton BERISHA
Pronar
"ALBATEC" SH.P.K.
Radio Drenasi
R023
Rr/Shendeti p.n.
Drenas

Ref: 1408/964/KPM/ni

VENDIM

për refuzimin e kërkesës për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio Drenasi – Komuna e Drenasit

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6 të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Drenasi është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është i licencuar për të transmetuar radio programe në shërbim të qytetarëve të Komunës së Drenasit.
3. Më 30 tetor 2009, Radio Drenasi është pajisur me licencë afatgjatë të KPM-së, ndërsa më 11 qershor 2014 është bërë ndryshimi i pronësisë së këtij subjekti transmetues.
4. Më 29 korrik 2014, Radio Drenasi ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e vendndodhjes së lokacionit të sistemit të transmetimit nga pika e transmetimit në qytetin e Drenasit, për ku janë të licencuar për të transmetuar, për të kaluar me transmetim në fshatin Berishë, respektivisht nga Malet e Berishës.
5. Arsyetimi i pronarit të Radio Drenasit për ndërrimin e lokacionit të sistemit të transmetimit mbështetet në përmirësimin e kualitetit të sinjalit dhe mbulueshmërisë më të mirë, me theks të veçantë në: Komoran, Korroticë e Epërme, Korroticë e Ulët,

Polac, Arllat, Bytyq, Gjergjicë, Nekocë, Fushticë, Sankoc, Skenderaj dhe në disa rrugë magjistrale. Arsye shtesë për ndërrim të lokacionit është potencuar edhe ankesa e banorëve të Komunës së Drenasit, të cilët jetojnë në lagjen ku është i vendosur transmetuesi i Radio Drenasit. Arsye tjetër e kësaj kërkesë është edhe rritja së përfitimeve financiare.

6. Më 7 gusht 2014, Departamenti i Menaxhimit Frekuencor (DMF) i KPM-së ka realizuar matjet teknike për të vlerësuar gjendjen faktike në terren si dhe mundësinë për të realizuar ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit sipas kërkesës së Radio Drenasit.

Arsyetim

7. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisioni i Pavarur për Media, përcakton se KPM, është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
8. Neni 16 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, paragrafi 1 thekson se: *Përveç dispozitave për bartjen e pronësisë të specifikuar në Nenin 15, i Licencuari paraprakisht parashtron kërkesë me shkrim për ndryshimet e specifikuar në paragrafet e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Rrezatuar Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm pasi të jenë miratuar nga ana e KPM-së.*
9. Neni 16 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, paragrafi 2, poashtu thekson se: *“Me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim të të Licencuarit, KPM-ja mund të ndryshojë kushtet e Pjesës 2, Standardet Teknike, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së transmetimit me një procedurë të përcaktuar në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së. KPM-ja do të sigurohet që këto ndryshime janë të domosdoshme për të garantuar një përdorim më të rregullt të spektrit frekuencor”.*
10. Në bazë të vlerësimit të rezultateve të DMF-së, frekuenca 92.1 MHz, që shfrytëzohet nga Radio Drenasi, nuk është e koordinuar ndërkombëtarisht për transmetim nga pika në Berishë, prandaj, ekziston mundësia që të ketë ndërhyrje në sinjal nga jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Në këtë mënyrë, KPM e ka të pamundur mbrojtjen e kësaj frekuence e që nuk është frekuencë e koordinuar.
11. Në bazë të vlerësimit të rezultateve të DMF-së, ndryshimi i lokacionit të transmetimit sipas kërkesës së Radio Drenasit, për të zhvendosur transmetuesin nga qyteti i Drenasit në pikën e transmetimit në Berishë, do të ndikojë në zvogëlimin e zonës së mbulueshmërisë në Komunën e Drenasit për 35.49%, pra nga 74.6% sa mbulon aktualisht, nga transmetimi nga pika e propozuar në Berishë mbulueshmëria do të zvogëlohet në 39.11%. Një ndryshimi i tillë nuk është me interes publik për qytetarët e Komunës së Drenasit.

Vendim

12. Komisioni merr vendim që, kërkesa e Radio Drenasit të refuzohet për dy arsye: 1. frekuenca 92.1 MHz nuk është e koordinuar ndërkombëtarisht për transmetim nga pika e Berishës, dhe 2. ndryshimi i vendndodhjes së sistemit të transmetimit nga qyteti i Drenasit, duke kaluar në pikën e Berishës, do të rezultojë me zvogëlim të mbulueshmërisë së Komunës së Drenasit.

Lëshimi i Vendimit

13. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti është i vlefshëm që nga data e nënshkrimit të tij.



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



16.09.2014
datë